

NEOFAS SILICONE STRUCTURE

Veshje dekorative fasade silikonike, premium, gati për përdorim, me rezistencë të jashtëzakonshme ndaj ujit.



PAKETIMI

25kg



KONSUMI

2kg/m²-1mm | 3kg/m²-1.5mm | 3.6kg/m²-2mm

Përshkrimi

NEOFAS SILICONE STRUCTURE është një veshje dekorative fasade silikonike, premium, gati për përdorim, me rezistencë të jashtëzakonshme ndaj ujit. Produkti karakterizohet nga elasticitet i lartë dhe ngjitje shumë e mirë mbi nënshtresë. NEOFAS SILICONE STRUCTURE siguron përshkueshmëri të shkëlqyer të avullit, parandalon formimin e çarjeve dhe eliminon nevojën për lyerje të fasadës pas aplikimit.

Fushat e Përdorimit

Përdoret si shtresë përfundimtare e hollë në sistemet e suvatimit, për të krijuar një shtresë të bardhë ose të ngjyrosur, hidrofobik. Përdoret si shtresë dekorative përfundimtare në Sistemet e Izolimit Termik të NEON Paints.

Përgatitja e Sipërfaqes

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër nga pluhuri, yndyrat, grimcat, bojërat ekzistuese etj. Rekomandohet lagia paraprake e sipërfaqes. Përmirësoni aderencën e NEOFAS SILICONE FULL duke përdorur NEOPRIM PRIMER GRAFIATO.

Aplikimi

NEOFAS SILICONE STRUCTURE duhet të përzihet mirë para aplikimit, me lëvizje të ngadalta dhe rrethore, për të shmangur futjen e ajrit.

Aplikohet manualisht me shpatull çeliku inox të lëmuar ose me makinë suvatimi. Sa kohë që materiali nuk është tharë plotësisht (5–15 minuta pas aplikimit), NEOFAS SILICONE STRUCTURE strukturohet/teksturohet me shpatull plastike.

Konsumi

2 kg/m² për trashësi 1 mm

3 kg/m² për trashësi 1.5 mm

3.6 kg/m² për trashësi 2 mm

Konsumi varion në varësi të nënshtresës.

Magazini

Temperatura e rekomanduar e ruajtjes:

5°C–38°C. Produkti duhet të mbahet i mbylluri dhe të ruhet në një ambient të freskët dhe të thatë.

Karakteristika



NEON
COLORING
SYSTEM

BASES
TR

Të dhëna teknike (NE +23 ° C DHE 50% U.R.)

Aparenca	Paste
Ngjyra	E bardhe
Densiteti (ISO2811, DIN 53217, ASTM D 1475)	1.7-2 g/cm ³
Viskoziteti (RVDV -2T,R7)	15000-30000 cp
Rezistenca ndaj prerjes (RVDV -2T, R7)	30000-600000 newton/m ²
Viskoziteti Kinematik (RVDV -2T,R7)	5000-10000 mm ² /s
pH	≥8

NEON Paints

Tiranë, Albania

info@neonpaints.euwww.neonpaints.eu

T: +355 69 20 94 570